



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1735/5 prot.

Datë 30.07.2025

V E N D I M

Nr. 985/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Gjergj Mersini	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 30.07.2025 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Zdrava 07” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-45761-04-22-2025 me objekt: “Blerje dhe vendosje rafte metalike për nevojat e Autoritetit Rrugor Shqiptar”, me fond limit 3,000,000 (tre milion) lekë pa tvsh, zhvilluar në datë 05.05.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “FRAL-2000” SHPK në procedurën e prokurimit sipërcituar.

Ankimues:

Operatori ekonomik “Zdrava 07” SHPK me NIPT L34131401F dhe adresë Lagjia Saver, Autostrada Lushnje-Fier, km 4.

Subjekt i interesuar:

Operatori ekonomik “FRAL-2000” SHPK me NIPT K06605226B dhe adresë Njesia bashkiake nr 7, Rruga e

Kavajes, pallati Condor Center, kati perdhe, dyqani nr 1, zona kadastrale, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor:

Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a
Rruga “Rreshit Çollaku” Godina Nr 6/337, Tiranë (në krah të Gjykatës së Lartë)

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përllogaritur për procedurën e prokurimit objekt - ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*” i ndryshuar.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 23.04.2025 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Procedurë e hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-45761-04-22-2025 me objekt: “Blerje dhe vendosje rafte metalike për nevojat e Autoritetit Rrugor Shqiptar”, me fond limit 3,000,000 lekë pa tvsh, zhvilluar në datë 05.05.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.

II.2. Në datë 05.05.2025 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se **në datën 09.05.2025** është bërë klasifikimi i operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, si më poshtë:

1. “GS-Provider” sh.p.k	0	lekë	I skualifikuar
2. “FRAL 2000” sh.p.k	1,490,000.00	lekë	I skualifikuar
3. “ZDRAVA 07” sh.p.k	2,036,000.00	lekë	I kualifikuar
4. “MUCA” sh.p.k	2,250,000.00	lekë	I kualifikuar
5. “SHAGA” sh.p.k	2,313,360.00	lekë	I skualifikuar
6. “HB-GROUPCONSTRUCTION” sh.p.k	2,334,000.00	lekë	I skualifikuar
7. “ARTEO 2018” sh.p.k	2,910,000.00	lekë	I kualifikuar
8. “EKM Konstruksion & Teknologji” sh.p.k	2,397,000.00	lekë	I skualifikuar

II.4. Referuar sistemit të prokurimit elektronik rezulton se në datën 19.05.2025 është publikuar “Njoftimi i fituesit paraprak”, dhe publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike me nr. 27 datë 26.05.2025, ku është shpallur fitues operatori ekonomik “Zdrava” shpk.

II.5. Në datën 11.06.2025 Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin nr. 765/2025, ku vendosi:

1. *Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Muca” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-45761-04-22-2025 me objekt: “Blerje dhe vendosje rafte metalike për nevojat e Autoritetit Rrugor Shqiptar”, me fond limit 3,000,000 lekë pa tvsh, zhvilluar në datë 05.05.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.*
2. *Autoriteti kontraktues të kryejë rivlerësimin e procedurës së mësipërme në zbatim të konstatimeve të bëra nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave të autoritetit kontraktor.*
3. *Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.*
4. *Ngarkohet zyra e financës, të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare, të paguar nga operatori ekonomik “Muca” SHPK.*
5. *Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
6. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

II.6. Në datën 20.06.2025 Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin nr. 800/2025, ku vendosi:

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “Procedurë e hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-45761-04-22-2025 me objekt: “Blerje dhe vendosje rafte metalike për nevojat e Autoritetit Rrugor Shqiptar”, me fond limit 3,000,000 lekë pa tvsh, zhvilluar në datë 05.05.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

II.7. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se **në datën 17.06.2025 - 24.06.2025**, është bërë **ri-klasifikimi** i operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, si më poshtë:

1. “GS-Provider” sh.p.k	0	lekë	I skualifikuar
2. “FRAL 2000” sh.p.k	1,490,000.00	lekë	I skualifikuar
3. “ZDRAVA 07” sh.p.k	2,036,000.00	lekë	I skualifikuar
4. “MUCA” sh.p.k	2,250,000.00	lekë	I kualifikuar
5. “SHAGA” sh.p.k	2,313,360.00	lekë	I skualifikuar
6. “HB-GROUPCONSTRUCTION” sh.p.k	2,334,000.00	lekë	I skualifikuar
7. “ARTEO 2018” sh.p.k	2,910,000.00	lekë	I kualifikuar
8. “EKM Konstruksion & Teknologji” sh.p.k	2,397,000.00	lekë	I skualifikuar

Me arsye skualifikimi si më poshtë vijon, për operatorin ekonomik ankimues “ZDRAVA 07” sh.p.k:

“Oferta ekonomike rezulton anomalisht e ulë.”.

II.8. Referuar sistemit të prokurimit elektronik rezulton se në datën 26.06.2025 është publikuar “Njoftimi i fituesit paraprak”, dhe publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike me nr. 30 datë 30.06.2025, ku është shpallur fitues operatori ekonomik “MUCA” shpk.

II.9. Në datën 02.07.2025 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër protokolli 1735/2025 prot., datë 02.07.2025 e operatorit ekonomik “Zdrava 07” SHPK për procedurën e prokurimit objekt ankimi. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Zdrava 07” SHPK SHPK, si dhe me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “FRAL-2000” SHPK, i cili nuk përmbush kriteret e vendosura për kualifikim sipas kriterëve të kualifikimit të bërë nga autoriteti kontraktor, në procedurën e prokurimit të sipërcituar. Konkretisht:

[.....Shoqeria ZDRAVA 07 shpk gjykon se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave pranë Operatorit të Blerjeve të Përqendruara ka bërë një vlerësim tendencioz dhe jo transparent ndaj ankesës së shoqërisë MUCA shpk duke pranuar atë pjesërisht me qëllim të vetëm skualifikimin e ofertës me ulët ekonomike të shoqërisë ZDRAVA 07 SHPK. OBP duke bërë një praninë pjesërisht të ankesës së

shoqerise MUCA SHPK, ka riskualifikuar me arsyetim te ndryshem nje shoqeri te skualifikuar me pare (FRAL 2000) duke realizuar ne kete menyre ndryshimit e mesatares se ofertave te kualifikuara me qellim skualifikimin me pas te shoqerise ZDRAVA 07 SHPK pasi nË rastin kur janË tË vlefshme tri ose mË shumË oferta, nË pËrputhje me nenin 93, tË LPP-sË, oferta vlerËsohet anomalisht e ulËt nËse vlera e saj do tË jetË mË e vogËl se 85% e mesatares sË ofertave tË vlefshme. $MO = 2,036,000 + 2,250,000 + 2,910,000 = 2,398,666.67$ $PR = 85\% Mo = 2,038,866.67$ Nga pËrlllogaritja rezultoi se oferta e OE iZdrava 07i sh.p.k, me Nipt: L34131401F ËshtË anomalisht e ulËt. Aryeja e riskualifikimit me motivacion te ndryshem ndaj shoqerise FRAL 2000 nga ana e KSHA vjen si rrjedhoje e ankimit te shoqerise MUCA shpk ku ne nje pike te ankese se saje kerkon: - RI-skualifikimin e e shoqerise FRAL 2000 pasi certifikatat e dorezuar prane AK , ISO 9001-2015 dhe ISO 14001-2025 pasi nuk jane te njehsuara me origjinalin. Kete pranim pjesor me kete motivim nga ana KSHA e konsiderojme teresisht tendencioz dhe jo ligjor me qellimin e vetem per te skualifikuar shoqerine ZDRAVA 07 SHPK (pasi AK e shpalli fitues njehere)....

Si perfundim theksojme se rivleresimi i ofertes se shoqerise FRAL 2000 per arsyet e lart permendura ka prekur interesin e shoqerise ZDRAVA 07 SHPK pasi ky rivleresim ka sjell si pasoje skualifikim e ofertes ekonomike te shoqerise. Kete rivleresim nga ana e KSHA dhe AK e konsiderojme jo transparent dhe jo ligjor pasi nuk eshte ne perputhje me Ligji Nr.162/2020, date 23.12.2020 iPer Prokurimet PublikeË, i ndryshuar VKM-se nr.285 date 09.05.2021 iPer miratimin e Rregullave te Prokurimit PublikË, pasi nuk eshte bere shqyrtim i thelluar mbi kete pjese te ankeses duke nxituar vendimarrjen me pasoja per proceduren. Per sa me lart kerkojme: 1. rivleresimin e ofertes se shoqerise FRAL 2000 per arsyetimin e skuafikimit te saje per dokumentat ligjore 2. Kuafifikimin e ofertes se shoqerise ZDRAVA 07 si rrjedhoje e rivleresimit si oferte jo anomalisht e ulet.....]

II.10. Bazuar nË nenin 112, pika 3, tË ligjit 162/2020 “PËr prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar nË bazËn e tË dhËnave tË tij, tË dhËna pËr: a) ankimuesin, adresËn dhe NUIS-in; b) tË dhËna tË plota pËr procedurËn e prokurimit (objekt, numËr reference, fond limit, datËn e zhvillimit tË procedurËs) si dhe formularin pËr publikim Nr. 1735/1 prot., datË 03.07.2025 lidhur me skualifikimin e operatorit ekonomik ankimues “Zdrava” 07 SHPK, qË kundËrshton me anË tË ankesËs me nr. 1735/2025 prot., datË 02.07.2025. Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik publikoi pretendimet e ankimuesit, mbi skualifikimin e ofertËs sË paraqitur nga operatori ekonomik “FRAL-2000” SHPK, pËr mospËrmbushjen e kriterit 2.3.2.

II.11. Me shkresËn pËrcjellËse me nr.1666/15 prot., datË 10.07.2025, protokolluar me tonË me nr. 1735/2 prot., datË 11.07.2025, nËpËrmjet shËrbimit postar, autoriteti kontraktor ka dËrguar informacionin e kËrkuar, shoqËruar me dokumentacion mbËshtetËs, ku ka **refuzuar** pretendimet e subjektit ankimues.

II.12. Nga shqyrtimi i akteve tË ndodhura nË fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se operatorËt ekonomikË tË interesuar nË kËtË procedurË prokurimi, nuk kanË dorËzuar argumente nË pËrputhje me nenin 113 tË LPP-sË, i ndryshuar, nË formË shkresore apo nË sistemin e ankesave elektronike.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor dhe verifikimeve të kryera,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendim e operatorit ekonomik ankimues “Zdrava 07” shpk, për kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij, me arsyetimin se: *[.....Shoqeria ZDRAVA 07 shpk gjykon se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave prane Operatorit të Blerjeve të Përqendruara ka bere nje vleresim tendencioz dhe jo transparent ndaj ankeses se shoqerise MUCA shpk duke pranuar ate pjeserisht me qellim te vetem skualifikimin e ofertes me ulet ekonomike te shoqerise ZDRAVA 07 SHPK. OBP duke bere nje pranin pjesor te ankeses se shoqerise MUCA SHPK, ka riskualifikuar me arsyetim te ndryshem nje shoqeri te skualifikuar me pare (FRAL 2000) duke realizuar ne kete menyre ndryshimit e mesatares se ofertave te kualifikuara me qellim skualifikimin me pas te shoqerise ZDRAVA 07 SHPK pasi nË rastin kur janË tË vlefshme tri ose mË shumË oferta, nË pËrputhje me nenin 93, tË LPP-sË, oferta vlerËsohet anomalisht e ulËt nËse vlera e saj do tË jetË mË e vogËl se 85% e mesatares sË ofertave tË vlefshme. $MO = 2,036,000 + 2,250,000 + 2,910,000 = 2,398,666.67$ $PR = 85\%$ $Mo = 2,038,866.67$ Nga pËrlogaritja rezultoi se oferta e OE iZdrava 07i sh.p.k, me Nipt: L34131401F ËshtË anomalisht e ulËt. Aryeja e riskualifikimit me motivacion te ndryshem ndaj shoqerise FRAL 2000 nga ana e KSHA vjen si rrjedhoje e ankimit te shoqerise MUCA shpk ku ne nje pike te ankeses se saj e kerkon: - RI-skualifikimin e e shoqerise FRAL 2000 pasi certifikatat e dorezuar prane AK , ISO 9001-2015 dhe ISO 14001-2025 pasi nuk jane te njehsuara me origjinalin. Kete pranim pjesor me kete motivim nga ana KSHA e konsiderojme teresisht tendencioz dhe jo ligjor me qellimin e vetem per te skualifikuar shoqerine ZDRAVA 07 SHPK (pasi AK e shpalli fitues njehere)....*

Si perfundim theksojme se rivleresimi i ofertes se shoqerise FRAL 2000 per arsyet e lart permendura ka prekur interesin e shoqerise ZDRAVA 07 SHPK pasi ky rivleresim ka sjell si pasoje skualifikim e ofertes ekonomike te shoqerise. Kete rivleresim nga ana e KSHA dhe AK e konsiderojme jo transparent dhe jo ligjor pasi nuk eshte ne perputhje me Ligji Nr.162/2020, date 23.12.2020 iPer Prokurimet PublikeË, i ndryshuar VKM-se nr.285 date 09.05.2021 iPer miratimin e Rregullave te Prokurimit PublikË, pasi nuk eshte bere shqyrtim i thelluar mbi kete pjese te ankeses duke nxituar vendimarrjen me pasoja per proceduren. Per sa me lart kerkojme: 1. rivleresimin e ofertes se shoqerise FRAL 2000 per arsyetimin e skualifikimit te saj per dokumentat ligjore 2. Kuafifikimin e ofertes se shoqerise ZDRAVA 07 si rrjedhoje e rivleresimit si oferte jo anomalisht e ulet.....], Komisioni i Prokurimit Publik vËren se,

III.1.1. Neni 24, pika 1, “Komisioni i prokurimit Publik” i Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: *“1. Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit dhe kryen*

çdo detyrë tjetër që i ngarkohet me këtë ligj dhe akte të tjera ligjore brenda fushës së kompetencave të tij. Komisioni i Prokurimit Publik administron të dhënat e Sistemit të Ankesave Elektronike.”

Në nenin 111, pika 1, “Paraqitja e ankesës” të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“1. Operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik. Rregulla të posaçme për mënyrën e paraqitjes së ankesës përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.”*

Neni 112, pikat 1,2 dhe 3 “Veprimet paraprake” të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: *“1. Me regjistrimin e ankesës në Sistemin e Ankesave Elektronike dhe publikimin e saj nga Komisioni i Prokurimit Publik, Sistemi i Prokurimit Elektronik në ndërveprim me Sistemin e Ankesave Elektronike pezullon në mënyrë automatike vazhdimin e procedurës së prokurimit deri në shqyrtimin plotësisht të ankesës, përfshirë edhe nxjerrjen e një vendimi nga Komisioni i Prokurimit Publik me nënshkrim dhe vulë elektronike. Sistemi duhet të zhvillohet duke përdorur teknologji të avancuara të inteligjencës artificiale dhe procese të robotizuara për të kryer pezullimin dhe nxjerrjen nga pezullimi automatik i procedurave të prokurimit. 2. Komisioni i Prokurimit Publik, me marrjen e ankesës në përputhje me këtë ligj, publikon në bazën e të dhënave përmes ndërveprimit me sisteme të treta, të dhënat e mëposhtme: a) për ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës). 3. Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, Komisioni i Prokurimit Publik publikon: a) ankesën e plotë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit; b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar; c) pretendimet mbi kualifikimin/skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime.”*

III.1.2. Në nenin 94 pika 1 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet: *1. Çdo operator ekonomik, i cili ka ose ka pasur interes të ligjshëm në një procedurë prokurimi sipas LPP, dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga veprimet ose mosveprimet e autoritetit/entit kontraktor, për të cilat pretendon se janë në kundërshtim me ligjin, ka të drejtë të ankohet pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.*

III.1.3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vlerësimit të ofertave në SPE, Komisioni vëren se oferta e operatorit ekonomik ankimues është skualifikuar me arsye si vijon: ***Në mbështetje të nenit 93, të Ligjit Nr. 162/2020, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Operatori ekonomik “Zdrava 07” ShPK me ofertë ekonomike 2,036,000.00 lekë pa TVSH, u skualifikua nga autoriteti kontraktor për shkak se vlера e ofertuar rezulton të jetë anomalisht e ulët.***

Në rastin konkret, në zbatim të pikës 5, të nenit 93 të LPP-së në të cilin përcaktohet se: *“në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, autoritetet ose entet kontraktore refuzojnë pa kërkuar shpjegime një ofertë, e cila është konstatuar anomalisht e ulët”,* procedura e prokurimit objekt - shqyrtimi e ka fondin limit 3,000,000 (tre milion) lekë pa tvsh, vlerë e cila

rezulton nën kufirin e lartë monetar, referuar Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.291, datë 15.05.2024 “Për përcaktimin e kufijve monetarë në procedurat e prokurimit publik”, kreu II pika 1 ku përcaktohet se: *1. Kufiri i lartë monetar në sektorin klasik është, si më poshtë vijon:*

a) Për procedurat e prokurimit për punë publike, e barabartë ose më e madhe se vlera 603 000000 (gjashtëqind e tre milionë) lekë;

b) Për procedurat e prokurimit për mallra, shërbime dhe konkurset e projektimit, e barabartë ose më e madhe se vlera 16 000 000 (gjashtëmbëdhjetë milionë) lekë.

Në këto kushte, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se vendimi i KVO-së për skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Zdrava 07” ShPK është i drejtë, pasi ndryshimet e ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, kanë hyrë në fuqi më datë 20.03.2024, ndërkohë që urdhri i prokurimit për procedurën e mësipërme të prokurimit mban datën 18.04.2025, ndaj për procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, siç është rasti në fjalë, autoriteti kontraktor e refuzon ofertën e cila është konstatuar anomalisht e ulët pa kërkuar shpjegime.

Në interpretim literal, sistematik dhe teologjik, me synim vendosjen në pah të ratio legis, mbështetur edhe në parimin e së drejtës se ratio legis est anima legis, (qëllimi i ligjit është edhe shpirti i ligjit), interesi i ligjshëm i operatorëve për të paraqitur ankim pranë autoritetit kontraktor si edhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik duhet të jetë dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i marrë nga autoriteti kontraktor në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik. Neni 94, pika 1 i Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, kërkon shprehimisht që ankimesi jo vetëm të ketë interes të ligjshëm por edhe të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor.

Në rastin konkret, Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se, operatori ekonomik ankimesi është njoftuar në përputhje me parashikimet e ligjit për prokurimin publik, në lidhje me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave pranë autoritetit kontraktor, i cili ka vendosur për skualifikimin e ofertës së këtij të fundit.

Brenda afateve të parashikuara të ankimit në nenin 110 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, ankimesi ka parashtruar pretendime mbi skualifikimin e vetës së tij si edhe mbi skualifikimin e operatorëve të tjerë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit objekt-ankimi. Ligjvënësi në nenin 110 e vijues të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” indryshuar, ka parashikuar afate strikte mbi paraqitjen e ankesës, afate të cilat për nga natyra juridike janë prekluzive.

Komisioni i Prokurimit Publik thekson se, LPP parashikon në mënyrë të qartë se për çdo vendimmarrje të autoritetit kontraktor, operatorët ekonomikë që rrezikojnë të dëmtohen nga ky vendim duhet të ushtrojnë të drejtën e tyre të ankimit njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik brenda afateve të parashikuara në LPP, duke respektuar të gjitha elementet formale sipas dispozitave ligjore.

Refruar ankesës Operatori ekonomik ankimues “Zdrava 07” SHPK, ka paraqitur pretendime mbi skualifikimin e vetës së tij si edhe pretendime mbi skualifikimin e operatorëve të tjerë pjesëmarrës.

Referuar përcaktimeve ligjore si më sipër cituar, kërkohet që ankimuesi, jo vetëm që duhet të ketë interes, por edhe të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor.

Një ankimues do të konsiderohet i dëmtuar apo disavantazhuar, kur ai ka vuajtur apo rrezikon dukshëm të vuajë një pasojë të ardhur drejtpërdrejtë nga veprimi i autoritetit kontraktor dhe kjo mund të rregullohet përmes ankimit pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik. Gjithashtu, akti i pretenduar duhet të ketë ndodhur në hapësirën e të drejtave të tij ligjore në kuadrin e një procedure prokurimi publik.

III.1.4. Komisioni vëren se i vetmi interes i ligjshëm që mund të ketë një operator ekonomik i dëmtuar nga një vendim i një autoriteti kontraktor, i dhënë në kuadrin e një procedure prokurimi është, që përmes ankimit ai të fitojë kontratën.

Komisioni gjykon se, operatori ekonomik ankimues “Zdrava 07” SHPK nuk legjitimohet për të paraqitur ankesë për operatorët e tjerë ekonomikë të skualifikuar, për sa kohë vetë rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit objekt-ankimi, duke mos gëzuar asnjë interes të ligjshëm në këtë procedurë prokurimi në kuptim të nenit 94 pika 1 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Sa më sipër pretendimet e operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e ankimuesit “Zdrava 07” SHPK mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “FRAL 2000” SHPK, KPP vëren se nga verifikimi i raportit të auditit në SPE gjendja juridike dhe faktike e operatorit ekonomik “FRAL 2000” SHPK rezulton i skualifikuar nga autoriteti kontraktor për shkak të paraqitjes së ofertës anomalisht të ulët nga ana e tij, për të cilin ky operator ekonomik nuk ka paraqitur ankesë njëherazi në KPP dhe në autoritet kontraktor përmes sistemit të ankesave elektronike brenda afatit të përcaktuar në nenin 110 pika 2 të LPP-së. Duke qenë se statusi i operatorit ekonomik “FRAL 2000” SHPK nga vlerësimi i KVO-së rezulton i skualifikuar dhe ky operator ekonomik nuk ka paraqitur ankesë në KPP dhe autoritet kontraktor brenda afateve të sipërcituara, pretendimet e operatorit ekonomik “Zdrava 07” SHPK për operatorin ekonomik “FRAL 2000” SHPK nuk do të merren në shqyrtim sepse ai nuk ka se si të dëmtohet nga një operator ekonomik i skualifikuar me vendim të KVO-së së autoritetit kontraktor për të cilin ky operator nuk ka paraqitur ankesë në autoritet kontraktor dhe në KPP brenda afateve ligjore.

Sa më lart pretendimet e operatorit ekonomik “Zdrava 07” SHPK për operatorin ekonomik “Fral 2000” SHPK nuk do të merren në shqyrtim.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë

Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Zdrava 07” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-45761-04-22-2025 me objekt: “Blerje dhe vendosje rafte metalike për nevojat e Autoritetit Rrugor Shqiptar”, me fond limit 3,000,000 lekë pa tvsh, zhvilluar në datë 05.05.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.
 2. Autoriteti kontraktues lejohet të vijojë me hapa të mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
 3. Ngarkohet zyra e financës, të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare, të paguar nga operatori ekonomik “Zdrava 07” SHPK.
 4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

